

Momenti i ri i zgjerimit në BE: Çfarë mund të përfitojë Kosova?

Gjeraqina Tuhina/Augustin Palokaj



Janar 2018

Titulli: Momenti i ri i zgjerimit në BE: Çfarë mund të përfitojë Kosova?

Autorë: Augustin Palokaj, Gjeraqina Tuhina

Publikuar nga: Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur



Ky projekt është financuar nga granti i Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur. Opinione, gjetjet dhe përfundimet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e KFOS-it.

Përmbajtja

5	Hyrje
6	Çfarë zhvillimesh priten në vitin 2018, viti i fundit i plotë i mandatit të këtij Komisioni të udhëhequr nga Jean Claude Juncker
7	Strategjia e Komisionit Evropian për ripërtëritjen e procesit të
8	Afatet kohore për vendet më të avancuara
10	Bullgaria si kryesuese e radhës kthen Ballkanin në prioritet
11	Kontributi i shteteve anëtare në strategjinë e zgjerimit
12	Fokusimi në sundimin e ligjit dhe të drejtat themelore
13	Si do të ndjek tash e tutje BE progresin e vendeve kandidate apo kandidateve potencial nga rajoni i Ballkanit perëndimor
14	Çfarë mund të përfitojë Kosova në këto rrethana të reja që mund të krijohen në vitin 2018, që është vit kur edhe shënohet dhjetëvjetori i pavarësisë së Kosovës.
17	Konkluzat



Hyrje

Viti 2018 është përmendur nga shumë zyrtarë të lartë të Bashkimit Evropian dhe nga liderë të shteteve anëtare si një vit në të cilin do të mund të rikthehej dinamika e procesit të zgjerimit të Bashkimit Evropian me vendet e Ballkanit Perëndimor. BE e konsideron këtë proces si të rëndësishëm për të ardhmen por e kupton se këtij procesi duhet kthyer edhe besueshmërinë. Këtë vit pritet të përmbyllen negociatat mes 27 shteteve të BE-së dhe Mbretërisë së Bashkuar për daljen e këtij shteti nga anëtarësia.

Në këtë kohë për BE-në bëhet edhe më i rëndësishëm kthimi i besimit se procesi i zgjerimit do të vazhdoje dhe se vendimi i popullit Britanik për t'u larguar nga BE, nuk ka shënuar një kthesë në proces i cili do të çonte deri tek shpërbërja e BE-së.

Viti 2018 shënon edhe 15 vjetorin e Samitit të Selanikut në të cilin vendeve të Ballkanit Perëndimor iu dha perspektiva e integritimit në BE. Ky përvjetor është rast i mirë që BE të rikonfirmojë këtë përkushtim duke marrë parasysh se nga shtetet të cilat para 15 vitesh morën premtime për integritet në BE, vetëm Kroacia arriti ta kalojë tërë rrugën dhe të bëhet anëtare e Bashkimit Evropian.

Në këtë kuadër do të zhvillohet një samit i veçantë kushtuar Ballkanit perëndimor në Sofje me 17 dhe 18 maj të vitit 2018. Prej Selanikut e deri tek Sofja, në një periudhë 15 vjeçare, pak a shumë u sqaruan disa çështje që ishin të hapura në atë kohë. Në territorin e ish Jugosllavisë, pavarësinë e shpallën së pari Mali i zi e më pas edhe Kosova. Kështu tash në rajonin i cili përkufizohet si "Ballkani Perëndimor" janë gjashtë shtete të cilat nuk janë anëtare të BE-së por synojnë këtë. Por çështja e raporteve të BE-së me Kosovën, si dhe e dy shteteve të rajonit (Bosnje e Hercegovinës dhe Serbisë) mbetet ende e hapur. Kosova vazhdon të mos jetë e njohur si shtet nga 5 vendet anëtare të Bashkimit Evropian dhe kjo në masë të madhe ndikon edhe në qartësimin e asaj që quhet "rrugës Evropiane të Kosovës"¹.

Por në vitin 2018, e më së voni një vit më vonë, BE beson se do të arrihet një marrëveshje në dialogun mes Kosovës dhe Serbisë e cila do të mundësonte ecjen e Kosovës në rrugën e saj evropiane. Në qasjen e saj ndaj rajonit, BE do të fokusohet më shumë në prioritetet që kanë të bëjnë me bashkëpunimin rajonal, zgjidhjen e kontesteve bilaterale, zhvillimin e infrastrukturës dhe konektivitetit ndërkohë që nga vendet e rajonit do të kërkohen rezultate konkrete në luftë kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Fokus do të jetë edhe zhvillimi ekonomik, stabiliteti fiskal dhe zvogëlimi i papunësisë së të rinjve, që lidhet edhe me sistemin e shkolimit. Nga këto do të varet edhe niveli i përgatitjes së këtyre vendeve për anëtarësim në BE në një të ardhme. Në të ardhmen edhe vlerësimi i këtyre vendeve përmes raporteve të progresit do të fokusohet në këto tema.

Në bazë të asaj që është paralajmëruar në BE, pritjeve në rajon dhe vlerësimeve të ekspertëve në vitin 2018 do të mund të miratohet një strategji e cila do të sqaron renditjen e zhvillimeve për anëtarësimin në BE të Malit të zi dhe Serbisë deri në vitin 2025. Shqipëria dhe Maqedonia, si dy vende kandidatë, do të mund të marrin rekomandimin e Komisionit për nisjen e negociatave dhe nëse do të ketë vullnet tek të gjitha shtetet anëtare, edhe ti

1 Në BE vazhdojnë të kenë kujdes që gjatë përmendjes së Kosovës të mos përdoren formulime që lënë të kuptohet se Kosova trajtohet si shtet. Kjo për shkak se BE ka qëndrim neutral ndaj statusit të Kosovës. Kosova, pos që përmendet me fustotë të dakorduar gjatë dialogut me Serbinë, në dokumente strategjike përmendet si "partner" ndërsa në vende të "integritimeve në BE" përmendet termi më sipërfaqësor "rrugë evropiane".

nisin këto negociata. Bosnja e Hercegovina, e cila ka paraqitur para dy vitesh kërkesën për anëtarësim në BE, do të dorëzojë përgjigjet në pyetësorin e BE-së në mënyrë që Komisioni Evropian të përgatisë opinionin nëse ky shtet i përmbush kriteret për status kandidati. Kosova mbetet e vetmja që nuk ka bërë asnjë hap formal në këtë rrugëtim dhe Kryeministri i saj Ramush Haradinaj ka paralajmëruar se këtë vit Kosova do të aplikojë për status kandidati.

Nëse kjo ndodhë do të jetë një sfidë për Kosovën por edhe për Bashkimin Evropian. Por ky vit do të ketë edhe sfida për procesin e zgjerimit të cilat mund të paraqiten në disa vende anëtare ku, për shkak të rritjes së mbështetjes për partitë e ekstremit të djathtë, është rritur edhe kundërshtimi për procesin e zgjerimit. Në Austri, një parti e tillë madje është bërë edhe partner në koalicionin qeveritar dhe do të udhëheqë edhe me resorët kryesore të cilat kanë ndikim edhe në politikat e BE-së. Austria do ta ketë kryesimin e radhës së BE-së në gjysmën e dytë të vitit. Po ashtu largimi i Britanisë së madhe nga BE-ja do të ketë ndikim edhe në Ballkan ku ky shtet ka qenë jashtëzakonisht aktiv në mbështetje të perspektivës evropiane të tyre. Në këtë punim analizohen zhvillimet që priten këtë vit në BE në procesin e zgjerimit dhe gjasat që edhe Kosova të përfitojë konkretisht nga paralajmërimet për kthimin e besimit në këtë proces.

Çfarë zhvillimesh priten në vitin 2018, viti i fundit i plotë i mandatit të këtij Komisioni të udhëhequr nga Jean Claude Juncker

Komisioni Evropian në përbërjen aktuale ka hyrë në vitin e fundit të plotë të mandatit të tij. Një vit më vonë, në vitin 2019, do të zhvillohen zgjedhjet Evropiane pas së cilave do të formohet edhe Komisioni i ri për mandatin e ardhshëm pesëvjeçar. Gjykuar në bazë të deklaratës së Presidentit të Komisionit Evropian Jean Claude Juncker, viti 2018 do të shfrytëzohet si një rast për të rikthyer besimin në procesin e zgjerimit me vendet e Ballkanit Perëndimor. Këtë e ka paralajmëruar në fjalimin e tij vjetor për gjendjen e unionit Jean Claude Juncker.

“Nëse duam më shumë stabilitet në fqinjësinë tonë, atëherë ne duhet të mbajmë po ashtu një perspektivë të besueshme të zgjerimit për Ballkanin Perëndimor. Është e qartë se nuk do të ketë zgjerim të mëtejshëm gjatë mandatit të këtij komisioni dhe Parlamenti. Asnjë kandidat nuk është i gatshëm. Por më vonë Bashkimi Evropian do të jetë më i madh sesa numri 27. Vendet candidate duhet t'i japin prioritet më të madh gjatë negociatave sundimit të ligjit, drejtësisë dhe të drejtave themelore” ka thënë Juncker².

Menjëherë pas këtij fjalimi Komisioni Evropian ka nisur punimet në draftin e tekstit të një strategjie e cila pritet të miratohet në muajin shkurt të vitit 2018. Qëllimi i saj është që të caktohen temat të cilave BE do tu jep më së shumti rëndësi në proces dhe të përmenden edhe kushtet e edhe afatet kohore se kur do të mund të përmbylej procesi me vendet më të avancuara në negociatat e anëtarësimit.

Në pranverë, përkatësisht në muajin prill, Komisioni Evropian do të miratojë dhe publikojë edhe paketën tradicionale të zgjerimit të përcjellë me raportet individuale të progresit për

² Fjalimi i Presidentit të Komisionit Evropian Jean Claude Juncker para Parlamentit Evropian në Strasburg me 13 shtator 2017.

vendet e përfshira në procesin e zgjerimit. Përderisa në strategjinë që do të miratohet në shkurt nuk pritet të përmendet Turqia, vendi kandidat me stazhin më të gjatë, në paketën e zgjerimit, në prill do të përfshihet edhe ky shtet. Qëllimisht në BE duan ta ndajnë Ballkanin Perëndimor nga Turqia sepse për Turqinë ende ka shumë dilema nëse ai shtet duhet të bëhet apo jo anëtar i BE-së përderisa dilema të tilla nuk ka për vendet e Ballkanit Perëndimor, por mbetet vetëm pyetja se kur ato do ta arrijnë këtë qëllim.³

Me 18 maj në Sofje do të zhvillohet samiti i BE-së dhe Ballkanit Perëndimor, në 15 vjetorin e samitit të Selanikut, për të ripërtërirë përkushtimin e BE-së ndaj këtij rajoni. Bullgaria, si vend i afërt me rajonin, ka vënë zgjerimin drejt Ballkanit Perëndimor si një prej prioritetëve të kryesimit të radhës së BE-së. Në këtë samit pritet të rikonfirmohet perspektiva Evropiane e rajonit por edhe përkujtimi se procesi do të mbetet i bazuar në meritat individuale të vendeve candidate dhe kandidatëve potencial.

Gjatë verës në Londër pritet të zhvillohet edhe një samit në kuadër të procesit të Berlinit. Qeveria Britanike ka ofruar të jetë nikoqire e këtij takimi për të dëshmuar se largimi i saj nga BE-ja nuk do të thotë se do të humbet interesi i saj për rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe në këtë drejtim do të vazhdojë të bashkëpunojë me BE-në.

Në gjysmën e dytë të vitit, kryesimin e radhës së BE-së do ta merr Austria. Ky vend ka qenë gjithmonë një prej shtytësve më të mëdhenj të zgjerimit për vendet e Ballkanit Perëndimor. Tash kur në qeveri është edhe një parti e ekstremit të djathtë, ekziston frika se kjo do të mund të ndikojë edhe në sjelljen e Austrisë ndaj zgjerimit. Por diplomatët thonë se, përkundër koalicionit me FPO Kryeministri Sebastian Kurz, i cili si ish Ministër i jashtëm është dëshmuar me përkushtimin ndaj perspektivës evropiane të Ballkanit Perëndimor, ka siguruar se do të ketë kontinuitet në politikën e Austrisë dhe se çështjet e BE-së do të barthen në përgjegjësi të zyrës së Kancelarit e jo të mbeten në duart e Ministrisë së Jashtme.⁴

Strategjia e Komisionit Evropian për ripërtëritjen e procesit të zgjerimit

Strategjia e Komisionit Evropian e cila pritet të miratohet në muajin shkurt të vitit 2018 konsiderohet si një prej dokumenteve më konkrete që ky Komision në mandatin e tij pesëvjeçar ka bërë për perspektivën e zgjerimit ndaj Ballkanit Perëndimor. Por, bazuar në tekstet e drafteve të këtij dokumenti dhe në reagimet nga shtetet anëtare, ky dokument në fund mund të mos kuptohet aq inkurajues sa do të donin vendet e rajonit. Kjo ka të bëjë jo vetëm me datat e mundshme indikative se kur cili shtet do të mund të hynte në BE por edhe me paqartësitë që mbeten, sidomos kur është në pyetje qasja ndaj Kosovës.

Drafti i këtij dokumenti, i cili deri tek miratimi mund edhe të pësojë ndryshim, bën të qartë se fokusi i BE-së në të ardhmen do të jetë në tri çështje: sundimin e ligjit, zgjidhjen e kontesteve kufitare mes shteteve të rajonit para anëtarësimit në BE dhe normalizimi gjithëpërfshirës i raporteve të Kosovës dhe Serbisë, si një çështje që ndikon në tërë rajonin, e jo vetëm në këto dy vende.

3 Nga biseda e autorëve me disa diplomatë të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian. Tashmë edhe publikisht liderë shtetesh dhe qeverish flasin për nevojën e një alternative për Turqinë që të ketë një lloj „partneritetit të privilegjuar” që nuk do të ishte anëtarësi formale në BE.

4 Nga biseda me diplomatë në BE pas vizitës së parë të Sebastian Kurz në Bruksel në cilësinë e Kryeministrit.

Natyrisht edhe në këtë draft, pikërisht për shkak të Kosovës, përdoret termi “partnerët” në mënyrë që të evitohet përdorimi i termit “shtet”.

“Një normalizim gjithëpërfshirës i marrëdhënieve mes Serbisë dhe Kosovës në formën e një marrëveshjeje ligjërish obliguese është urgjente dhe kruciale për perspektivën evropiane edhe të Kosovës edhe të Serbisë, si dhe të rajonit në përgjithësi”⁵, thuhet në një draft të hershëm të dokumentit strategjik të Komisionit Evropian.

Dokumenti konfirmon perspektivën evropiane të gjithë rajonit si një proces të vazhdueshëm që nga Samiti i Selanikut në vitin 2003 dhe përmend se BE ka mbajtur një përkrahje të palëkundur për të ardhmen e gjithë rajonit si pjesë integrale e BE-së.

Element mjaft i rëndësishëm i strategjisë pritet të jetë edhe insistimi që BE të mos “importojë” problemet ndërkufitare që kanë shtetet e rajonit mes vete. Prandaj do të insistojë në të ardhmen që ato probleme të zgjidhen para anëtarësimit të tyre në BE. Këtë e tha në një konferencë për shtyp në Bruksel edhe Presidenti i Komisionit Evropian Jean Claude Juncker. “Nuk mund të luajmë me çështje të tilla. Të gjitha kontestet duhet të zgjidhen para se ato vende të hyjnë në BE” ka thënë ai.⁶

Kjo çështje është përfshirë edhe në draftin e strategjisë së Komisionit dhe shihet si pjesë e procesit të pajtimit në rajon, tejkalimit të ndasive nga e kaluara dhe bashkëpunimit rajonal. Sugjerohet që para se t’i përmbyllin negociatat e anëtarësimit vendet e rajonit ose ti kenë zgjidhur çështjet e hapura rreth kufijve përmes marrëveshjeve bilaterale, ose ti kenë dorëzuar ato para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, apo Arbitrazhit ndërkombëtar, me marrje të qartë të obligimeve që vendimet e tyre të pranohen dhe zbatohen.⁷ Në këtë gjë Komisioni Evropian insiston edhe për shkak të shembullit të Kroacisë dhe Sllovenisë. Për disa vite Sllovenia kishte bllokuar hapjen e disa kapitujve në negociatat e anëtarësimit të Kroacisë ndërsa tash Kroacia nuk pranon vendimin e Gjykatës së arbitrazhit, duke thënë se ajo është kontaminuar dhe diskredituar me ndikimin e dëshmuar të palejueshëm të Sllovenisë ndaj arbitrave.

Afatet kohore për vendet më të avancuara

Nëse Komisioni Evropian do të insiston në idenë e parë atëherë në dokumentin e strategjisë do të përmenden për herë të parë edhe afatet indikative kohore se kur do të mund të anëtarësohen në BE vendet më të avancuara, e tash ato janë Mali i Zi dhe Serbia. “Për herë të parë, perspektiva e tyre e anëtarësimit ka një afat kohor sipas skenarit **më të mirë të mundshëm**. Me ekzistimin e një vullneti të fortë politik, arritjen e reformave reale, dhe zgjidhjen afatgjate të kontesteve me fqinjët, Mali i Zi dhe Serbia do të duhej **të jenë të gatshme për** tu anëtarësuar deri në vitin 2025”⁸, thuhet në draft.

Ideja që të përmenden afate kohore vetëm për dy shtete ka hasur në reagime të shumta të diplomatëve të shteteve anëtare të BE-së por edhe të atyre nga vendet e rajonit. Një gjë e tillë është parë edhe si e rrezikshme sepse nuk përmendet asgjë konkrete për katër vendet të cilat nuk janë duke negociuar anëtarësimin (Shqipërinë, Maqedoninë, Bosnje e

5 Koha ditore. 2 dhjetor 2017.

6 Jean Claude Juncker në konferencë për shtyp në Bruksel me Presidentin e Sllovenisë Borut Pahor me 8 janar.

7 Nga drafti i strategjisë së Komisionit Evropian; “Perspektiva kredibile e zgjerimit për Ballkanin Perëndimor”

8 Nga drafti i strategjisë së Komisionit Evropian: “Perspektiva kredibile e zgjerimit për Ballkanin Perëndimor”

Hercegovinën dhe Kosovën). Në anën tjetër as Mali i Zi nuk është i kënaqur se përmendet bashkë me Serbinë sepse, nëse ka vende të avancuara në proces, atëherë pa dyshim është Mali i zi i cili deri në fund të 2017 tash ka hapur 30 nga 35 kapituj negociues ndërsa Serbia vetëm 12. Në anën tjetër Mali i Zi është edhe vend anëtar i NATO-s dhe nuk ka pengesa politike çfarë i ka Serbia, e as dyshime rreth orientimit të saj. Në këtë strategji pritet të përmendet edhe qartësia që duhet ta kenë liderët e rajonit se në cilin drejtim duan të shkojnë, në mënyrë që të mos ketë dyshime për orientimin e tyre për BE.

Varur nga përparimi në negociatat për zgjidhjen e çështjes së emrit të Maqedonisë dhe nga përmbushja e obligimeve nga Shqipëria, do të mund të shtohen edhe formulime më konkrete për këto dy shtete që kanë statusin e kandidatit por jo edhe vendim për nisjen e negociatave të anëtarësimit.

Në pjesën ku flitet për atë që mund të arrihet deri në vitin 2025, draft-dokumenti i hershëm kishte lënë dy variante. Sipas njërit thuhej se “Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, IRJM dhe Kosova deri atëherë duhet po ashtu të jenë mirë të avancuara në rrugën e tyre evropiane” ose “Negociatat me Shqipërinë, BeH-në, FYROM-in dhe Kosovën duhet po ashtu të jenë mirë të avancuara deri atëherë⁹”. Mes këtyre dy formulimeve, njëri prej të cilëve do të përmendet në strategji, ka shumë dallim. Sepse formulimi sipas së cilit deri në vitin 2025 “negociatat e anëtarësimit duhet të jenë në fazën e avancuar” është konkretë dhe do të ishte porosi inkurajuese politike. Por nëse kjo do të zbehet me fjalinë e “përparimit në rrugën evropiane” kjo nuk do të thotë shumë sepse “rruga evropiane” është term tepër i përgjithësuar i cili BE-në nuk e obligim në asgjë.

Mali i Zi dhe Serbia, sipas skenarit pozitiv, do të mund të përmbyllin negociatat e anëtarësimit deri në vitin 2023, më pas do të nënshkruhej Traktati i anëtarësimit dhe të ratifikohet i njëjti nga vendet anëtarë në mënyrë që deri në fund të vitit 2025 të mund të bëhen anëtare të Bashkimit Evropian.

“Agjenda është ambicioze, dhe mendohet të jetë nxitëse. Që të gjashtë partnerët nga Ballkani Perëndimor tani duhet të dyfishojnë përpjekjet, të adresojnë reformat vitale dhe të kompletojnë transformimet e tyre politike, ekonomike dhe shoqërore. Bashkimi në BE është shumë më tepër se sa një proces teknik. Është një zgjidhje e gjeneratës, e bazuar në vlera, të cilat secili shtet duhet ti përqafojë më aktivisht, prej politikave të tyre të jashtme dhe rajonale deri te ajo çka fëmijët e mësojnë në shkollë”, thuhet në draftin e strategjisë.

Sa herë që flitet për qëndrimet e Komisionit Evropian duhet gjithmonë të merren me rezervë dhe të mos prezantohen edhe si qëndrime të Bashkimit Evropian. Sepse në procesin e zgjerimit vendimet merren nga shtetet anëtare, dhe atë me konsensus në Këshill. Shembulli i Maqedonisë dëshmon më së miri se qëndrimet e Komisionit mund edhe të injorohen tërësisht nga Këshilli. Ky shtet sipas vlerësimit të Komisionit Evropian tash e disa vite i ka përmbushur kushtet për nisjen e negociatave. Komisioni ka rekomanduar nisjen e tyre por një gjë e tillë nuk ka ndodhur për shkak se nuk e lejon një shtet anëtar, Greqia. Por gjithsesi edhe kjo strategji jep një shpresë se Brukseli më seriozisht do t'i qaset rajonit të Ballkanit.

9 Nga drafti i strategjisë së Komisionit Evropian; “Perspektiva kredibile e zgjerimit për Ballkanin Perëndimor”.

Bullgaria si kryesuese e radhës kthen Ballkanin në prioritet

Në ditën e parë të vitit 2018, Bullgaria mori mandatin gjashtëmuor në cilësinë e kryesueses me Bashkimin Evropian. Ballkani Perëndimor, radhitet ndër prioritetet kyçe të presidencës bullgare. Në prezantimin e prioritetëve, Sofja zyrtare është e mendimit se perspektiva e qartë evropiane për rajonin është e domosdoshme. "Ambicia e Presidencës bullgare është të arrijë një plan veprimi të qartë me secilin nga vendet, pa krijuar shpresa joreale, por me hapa konkret. Kjo është mënyra më e mirë për të arritur paqe, siguri dhe prosperitet afatgjatë në rajon"¹⁰, thuhet në dokumentin e prioritetëve të presidencës Bullgare.

Që në takimin e parë të punës së qeverisë së Bullgarisë dhe Komisionit Evropian në Sofje Presidenti i Komisionit Jean Claude Juncker ka përsëritur rëndësinë e vazhimit të zgjerimit me Ballkanin Perëndimor dhe madje ka tërhequr vërejtjen se pa një perspektivë të qartë evropiane ekziston rreziku që të shohim ngjarje që do të na kthenin në vitet 90 të shekullit të kaluar, që ne nuk do të donim të përsëriten¹¹.

Përfaqësuesi i përhershëm i Bullgarisë pranë Bashkimit Evropian, Dimiter Tzantchev, gjatë prezantimit të prioritetëve bullgare në Bruksel ka tërhequr vërejtjen se problemet me të cilat është ballafaquar Evropa viteve të fundit kanë bërë që të largohet fokusi nga rajoni dhe si pasojë shumë nga vendet e Ballkanit Perëndimor, kanë "kërkuar ndihmë në vendet tjera". Andaj sipas tij, "është koha e fundit që BE të kthejë vëmendjen kah fqinjët e vet"¹². Qëllimi i Sofjes zyrtare është që gjatë mandatit në krye të BE-së të konfirmojë se perspektiva evropiane për Ballkanin Perëndimor është reale. "Bullgaria nuk dëshiron që të krijojë pritje joreale por ne jemi të gatshëm që të bisedojmë në lidhje me problemet me Ballkanin Perëndimor. Disa vende janë më të avancuara e disa tjera nuk janë, ndërsa ne duhet të bisedojmë me të gjitha vendet", ka porositur Dimiter Tzanchev.

Megjithatë, në mungesë të përkushtimit të qartë për integrim të plotë të të gjitha vendeve, presidenca Bullgare gjatë gjysmë-vjetorit të parë të vitit 2018, do të fokusohet më së shumti në ndërlidhjen e vendeve të Ballkanit Perëndimor, si në mes veti ashtu edhe në mes të shteteve të rajonit me shtete e BE-së.

Qëllimi është të sigurojë lidhje me vendet e Ballkanit Perëndimor - transport, ajër, energji, edukim dhe digjitalizim. Bullgaria investon përpjekje të vazhdueshme në këtë drejtim, për shembull duke promovuar politikat digjitale të BE-së midis vendeve të Ballkanit Perëndimor përmes reduktimit gradual të tarifave të roaming-ut dhe duke rritur mundësitë për qasje në internet me brez të gjerë.

Me 17 Maj në Sofje do të zhvillohet samiti i BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor për të ripërsëritur perspektiven evropiane e rajonit. Me këtë samit Bullgaria dëshiron ti jep mbështetje rajonit dhe ta rikonfirmojë përkushtimin e BE-së të dhënë para 15 vjetësh në Selanik, në kohën kur Bullgaria ende ishte në procesin e negociatave të anëtarësimit. Prej asaj kohe vetëm Kroacia u anëtarësua në BE. Shtete tjera kanë përparim të "pabarabartë" në proces të integritimeve. Serbia dhe Mali i Zi janë në proces të negociatave të anëtarësimit.

10 Dokumenti i prioritetëve të presidencës Bullgare të BE-së.

11 Nga konferenca për shtyp e Presidentit të Komisionit Evropian Jean Claude Juncker dhe Kryeministrit të Bullgarisë Bojko Borisov në Sofje me 12 janar.

12 Nga prezantimi i Përfaqësuesit të përhershëm të Bullgarisë në BE i programit të presidencës së radhës.

Maqedonia dhe Shqipëria kanë status kandidati por nuk kanë nisur negociatat ndërsa Bosnja dhe Hercegovina si dhe Kosova janë në dhomë të pritjes: Bosnja ka aplikuar për status kandidati, procesi ka nisur në Komisionin Evropian për të përpiluar opinionin rreth kësaj ndërsa Kosova ka në fuqi MSA-në.

Një prej temave tjera që Bullgaria në cilësinë e Kryesuesit të radhës dëshiron ta shtyjë gjatë gjysmës së parë të vitit 2018 është edhe heqja e tarifave të roaming-ut. Një gjë e tillë në krejt territorin e BE-së, konsiderohet si e arritura më e madhe në vitet e fundit. Tani po shikohen mënyrat se si të aplikohet e njëjta gjë edhe në vendet e rajonit, duke përfshirë këtu fillimisht heqjen e roaming-ut për vendet brenda Ballkanit Perëndimor e më pas edhe heqjen e tarifave në mes të Ballkanit dhe vendeve të BE-së. Ndërlidhja, përfshirë këtu edhe hapat e parë drejt heqjes së tarifave e të roaming-ut, do jetë edhe nga temat kryesore që do trajtohen në samitin e radhës BE-Ballkan Perëndimor i cili do mbahet në Sofje. Sipas ambasadorit, Tzantchev, tashmë ekziston gatishmëria e Komisionit Evropian që të përkrahë angazhimet drejt heqjen së tarifave të roaming-ut me Ballkanin Perëndimor.

Kontributi i shteteve anëtare në strategjinë e zgjerimit

Thirrja e Presidentit të Komisionit Evropian Jean Claude Juncker dhe e Komisionit që ai e Kryeson deri në vjeshtë të vitit 2019 që ti jepet një perspektivë më e qartë evropiane vendeve të Ballkanit Perëndimor ka hasur në mbështetje edhe të vendeve anëtare të BE-së, ndonëse në mënyra të ndryshme. Shumë prej tyre kanë dërguar letrat me idetë se si do të duhej të realizohej rritja e dinamikës së procesit të zgjerimit.

Në një letër të përbashkët nga 12 shtete të BE-së lidhur me zgjerimin ndaj Ballkanit Perëndimor, dhe një kontribut i përbashkët nga Suedia dhe Finlanda, kërkohet që të ndihmohen vendet e rajonit në përshpejtimin e rrugës së tyre drejt BE-së por po ashtu që të mos bëhen lëshime nga ana e Brukselit lidhur me politikën e kushtëzimeve.

Shtetet anëtare kanë përqendruar vëmendjen në strategjinë e Komisionit Evropian për shtetet e Ballkanit Perëndimor, e cila publikohet në muajin shkurt 2018. Ndryshimet fundamentale në skenën politike brenda shteteve anëtare kanë bërë që të ndërrojë edhe diskursi politik në lidhje me zgjerimin si temë jo shume e popullarizuar në opinionin evropian. Ndonëse të ndara në grupet pro dhe kundër zgjerimit brenda BE-së, shtetet anëtare kanë të përbashkët hezitimin që të obligohen me data konkrete të pranimit të vendeve të reja në familjen evropiane.

Në letrën të cilën Komisionit Evropian ia kanë dërguar 12 shtete anëtare kërkohet qartë që procesi i integritimit duhet të mbetet "i bazuar në progres e jo i bazuar në data"¹³ Andaj edhe në mes tjerash kërkohet që Strategjia e Komisionit Evropian të prezantojë "skenaret më të mira të mundshme" të integritimit të WB6¹⁴ që do mund të kishte efekte stabilizues dhe inkurajues. Megjithatë këto 12 shtete konsiderojnë se duhet të punohet me të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, pavarësisht se, që nga fjalimi vjetor i Jean Claude Juncker tashmë janë identifikuar cilat vende nga Ballkani do të mund të anëtarësohen të parat në BE¹⁵. Këto 12 shtetet anëtare të BE-së konsiderojnë se politikat evropiane duhet të imple-

13 „Non paper” i nënshkruar bashkërisht nga Austria, Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Irlanda, Italia, Lituania, Letonia, Malta, Polonia, Sllovenia dhe Sllovakia.

14 Shkurtesa WB6 (Western Balkans 6) përdoret për gjashtë shtetet e rajonit: Shqipërinë, Bosnje e Hercegovinën, Kosovën, Malin e zi, Maqedoninë dhe Serbinë.

15 Shtator 2017 – Letter of intent e kryetarit të Komisionit Evropian

mentohen nëpërmjet qasjes rajonale e cila konfirmon parimet e meritave individuale por edhe faktin se 6 shtetet e Ballkanit Perëndimor janë në faza të ndryshme të integritit dhe se në këtë kuadër ka edhe liderë në procese (Serbia dhe Mali i Zi). “Fokusimi vetëm në vendet specifike të Ballkanit perëndimor, mund të ketë ndikim negativ dhe mund të shkaktojë tensione në rajon¹⁶”, porosisin këto shtete.

Letra ne fjalë, i referohet periudhës 15 vjeçare nga samiti i Selanikut e deri më sot, andaj edhe kërkohet që Strategjia të “shtojë dhe avancojë” përkushtimin e BE-së për perspektiven kredibile evropiane për gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, mirëpo duke shtuar “shtresa të prekshme dhe konkrete” në politikën evropiane të zgjerimit në mënyrë që të vijë deri të përafrimi i WB6 madje edhe gjatë fazës së para-anëtarësimit.

Pak a shumë në linjë të njëjtë është edhe një letër si kontribut i përbashkët i Finlandës dhe Suedisë. Pos kësaj këto dy shtete propozojnë që monitorimi i përparimit në kapitujt 23 dhe 24, që merren me drejtësi dhe punë të brendshme, e që janë dy prej kapitujve kryesorë në procesin e zgjerimit, të bëhet edhe për vendet që nuk kanë status kandidati ende dhe nuk i kanë nisur negociatat. Shtetet tjera kanë dhënë ide edhe përmes komunikimeve verbale me Komisionin Evropian dhe vendet tjera anëtare të BE-së.

Fokusimi në sundimin e ligjit dhe të drejtat themelore

Bashkimi Evropian edhe në përpjekjet për të ringjallur procesin e zgjerimit do të rritë presionin për të luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin dhe për tu fokusuar në dy prej 35 kapitujve që janë të lidhura me këtë. Janë dy kapituj në procesin e negociatave të anëtarësimit që tashmë konsiderohen si më të ndërlikuarat e që përfshijnë sundimin e ligjit: kapitulli 23 që i referohet gjyqësorit dhe të drejtave themelore dhe kapitulli 24 i cili ka të bëjë me drejtësinë, lirinë dhe sigurinë. Me hapjen e perspektivës evropiane të vendeve të rajonit, dhe në dritë të problemeve neuralgjikë me të cilat ballafaqohet praktikisht secili shtet i Ballkanit Perëndimor në lëmenjtë e lartcekur, këto dy kapituj fituan në peshë viteve të fundit ndërsa rëndësia e tyre vetëm sa do shkojë e forcohet. Kjo bëhet e qartë me nisjen e negociatave të Malit të Zi e sidomos Serbisë, mirëpo edhe strategjia e Komisionit Evropian i kushton rëndësi të veçantë këtyre dy kapitujve. Kjo është gjithashtu kërkesë e shteteve anëtare të BE-së, të cilat janë të mendimit se të gjitha shtetet WB6 duhet të merren me reformat në këto lëmi madje edhe para nisjes konkrete të procesit të anëtarësimit.

Kështu, në letrën të cilën Suedia dhe Finlanda ia kanë dërguar Komisionit Evropian ku paraqesin pritjet se çfarë duhet të përfshihet në Strategji, kërkohet që legjislacioni i cili mbulon kapitujt 23 dhe 24, duhet të shqyrtohet madje edhe për ato vende të cilat akoma nuk kanë nisur procesin e anëtarësimit. Në këtë kuadër, Suedia dhe Finlanda konsiderojnë se ekzaminimi i legjislacioni në fjalë (për ato vende që nuk janë në proces të negociatave në anëtarësimit) duhet të plotësohet me bashkëpunimin në mes të vendeve nga WB6 dhe shtete anëtare të BE-së në ndërtimin e institucioneve dhe kapaciteteve (nga letra suedezo-finlandeze në lidhje me strategjinë e KE). “Procesi i anëtarësimit në BE duhet të revitalizohet nëpërmjet të fokusimit në reforma e jo nëpërmjet të hapjes së kapitujve të ri”, konsiderojnë politikbërësit të Stokholmit dhe Helsinkit. Qëndrim gati identik kanë edhe 12 shtete tjera të BE-së. Në letrën e ndarë të dërguar në selinë e Komisionit Evropian këto 12 shtete konsiderojnë se sundimi i ligjit është esencial për promovimin e transformimit të

16 “Non paper” i nënshkruar bashkërisht nga Austria, Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Irlanda, Italia, Lituania, Letonia, Malta, Polonia, Sllovenia dhe Sllovakia.

suksesshëm të bazuar në vlera, norma dhe standardet e BE-së. Bashkëpunimi i ngushtë në mes të shteteve anëtare dhe WB6 i shprehur në të dy letrat e që ka të bëjë me ndërtimin e institucioneve e kapaciteteve, do duhej të bëhet në nivel të secilit vend veç e veç por edhe në nivel rajonal.

Për shkak të përvojës nga e kaluara, pasi këto dy kapituj BE-ja i konsideron kryesorët, është ndryshuar qasja në procesin negociator në mënyrë që këto kapituj të hapen në fazën e hershme të negociatave dhe të ketë më shumë kohë për përmbushjen e kriterëve. Janë vendosur, pos kriterëve për hapje dhe mbyllje të këtyre kapitujve, edhe kriteret kalimtare. Në rastin e Serbisë dhe Malit të zi këto kriterë do të duhej të përmbushen deri në vitin 2019 në mënyrë që atëherë të caktohen kriteret për mbylljen e tyre.

Si do të ndjek tash e tutje BE progresin e vendeve kandidatë apo kandidatëve potencial nga rajoni i Ballkanit perëndimor

Komisioni Evropian vazhdon praktikën e monitorimit të përparimin të vendeve kandidatë dhe ato që konsiderohen "kandidatë potencial" përmes paketës së zgjerimit dhe raporteve individuale të progresit. Viti i kaluar ishte i pari në të cilin nuk pati raporte të tilla. Kjo ka ndodhur për shkak se në Komision është marrë vendimi që nga vjeshta (zakonisht fillimi i nëntorit) raportimi të bëhet në pranverë. Këtë vit raportet e progresit pritet të miratohen dhe publikohen në muajin Prill.

Tash e tutje do të bëhen gjithmonë në këtë periudhë të vitit. Dhe kjo ka një arsye të veçantë: BE do që ato të jenë ose si pjesë ose afër "paketës së pranverës" të raporteve në kuadër të semestrit Evropian që BE i bën për vendet anëtare. Ato kanë fokusin në situatën makro ekonomike, financat, aspektet buxhetore.

Ndonëse për vendet e përfshira në procesin e zgjerimit do të mbetet ende formati i Raporteve të progresit siç ka qenë deri me tash, duke i përfshirë të gjitha kapitujt negociues, ideja është që në të ardhmen të matet edhe më shumë se deri më tash progresi edhe i vendeve nga procesi i zgjerimit në fushat e ekonomisë dhe financave. Sepse ende mbetet për vite hendeuku i tashëm i këtyre vendeve me mesataren e BE-së sa i përket zhvillimit ekonomik atëherë do të jetë vështirë të bëhen ato vende anëtare, qoftë edhe nëse i përmbushin kushtet tjera formale.

Në të ardhmen në raportet e progresit do të ketë insistim më të qartë për reformat e kërkuara në sundimin e ligjit. Në të gjitha vendet e rajonit kërkohet pavarësia e plotë, paanshmëria dhe efikasiteti i gjyqësorit, ndërsa theksohet edhe nevoja për një luftë më bindëse kundër korrupsionit, pastrimit të parave dhe krimit të organizuar. Përmes monitorimit të progresit vendeve të rajonit do tu bëhet e qartë se anëtarësimi në BE nuk mund të arrihet pa ndërtimin e institucioneve të fuqishme e të pavarura të gjyqësorit, transparencës më të madhe në prokurimin publik, si dhe zhbërjes së rrjeteve të krimit të organizuar që ende vlerësohet se janë të fuqishme në rajon. Pastaj në luftë kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit do të kërkohen dëshmi konkrete, jo vetëm përmes përkushtimit politik, por edhe përmes vendimeve të plotfuqishme të gjykatave dhe konfiskimit të pasurisë së atyre që kanë ardhur deri tek ajo përmes veprave kriminale¹⁷. Në këtë mënyrë në Komisionin Evropian besojnë

17 Nga biseda me zyrtarë të përfshirë në procesin e raportimit të progresit

se do të sigurojnë edhe mbështetje për vendet e rajonit edhe do tu dëshmojnë vendeve të tashme anëtare se nuk do të ketë lëshime në politikën e kushtëzimeve.

Çfarë mund të përfitojë Kosova në këto rrethana të reja që mund të krijohen në vitin 2018, që është vit kur edhe shënohet dhjetëvjetori i pavarësisë së Kosovës.

Kosova vazhdon të jetë rasti më i paqartë sa i përket qasjes së Bashkimit Evropian ndaj rajonit të Ballkanit Perëndimor. Paqartësitë kanë të bëjnë kryesisht me dallimet që mbesin në BE rreth statusit të Kosovës ndërsa ato tash janë rritur edhe për shkak të zhvillimeve politike në Kosovë. Viti 2018 sjell disa raste edhe për Kosovën por edhe sfida që mund të kenë pasoja për të ardhmen e raporteve të saja me Bashkimin Evropian.

Pasi secili nga 5 shtetet tjera të rajonit ka mundësi që të shënoj hapa konkrete këtë vit në procesin e integritimeve Evropiane Kosova mbetet e vetmja për të cilën asgjë nuk mund të ofrohet konkretisht përpos porosive të përgjithësuara për “të ardhmen Evropiane “ apo “përparim në rrugën përkatëse Evropiane”. Strategjia e zgjerimit e Komisionit Evropian mund të përmend edhe afate të qarta kohore se kur do të mund të përmbyllin negociatat e kur të bëhen anëtare Mali i zi dhe Serbia. Shqipëria dhe Maqedonia mund të marrin rekomandimin e Komisionit Evropian gjatë këtij viti për të nisur negociatat e anëtarësimit. Bosnja e Hercegovina, e cila ka aplikuar për anëtarësim, pritet të dorëzojë më në fund përgjigjet në pyetësor dhe Komisioni të nis punën në përpilimin e opinionit për dhënien e statusit të kandidatit. Kosova nuk pritet të ketë ndonjë mundësi të ndonjë hapi konkret përpos nëse vendosë të bëjë aplikimin formal për anëtarësim në BE.

Sikur edhe për vendet tjera edhe për Kosovën do të miratohet Raporti i progresit. Ai do të identifikojë problemet e mëdha që ka Kosova në sundimin e ligjit, në shkollim, ruajtje të mjedisit, papunësisë dhe shumë fushave tjera. Keqësimi i raporteve me BE-në dhe shtetet e quintit në fund të vitit për shkak të Gjykatës speciale, si dhe rritja e animoziteteve në relacionin EULEX-autoritete të Kosovës, do të mund të ketë ndikim edhe në raportin e progresit.

Por sfida më e madhe edhe për Kosovën edhe për BE-në do të jetë nëse Kosova vendosë të aplikojë për status kandidati në BE. Në paraqitje që ka bërë Kryeministri Haradinaj ai ka përmendur edhe marrjen e statusit të kandidatit. Por për këtë, edhe kur ekzistojnë kushtet dhe kur rrethanat janë pozitive, ekziston një procedurë që duhet ndjekur. Dhe ajo procedurë nis me vendimin e qeverisë së Kosovës për të aplikuar për anëtarësim.

Aplikimi për anëtarësim në BE mund të jetë një test i domosdoshëm që Kosova ta bëjë por ai sjell edhe rreziqe. Në BE vështirë që do të ketë të atillë që do ta inkurajonin Kosovën ta bëjë një hap të tillë¹⁸. Kjo për shkak se aplikimi mund të mos merret fare parasysh, të mbyllet diku në sirtar, apo edhe të refuzohet për shkak të mosnjohjes nga 5 vendet anëtare¹⁹. Pra Kosova pa dyshim do të merrte një rrezik me këtë veprim sepse, nëse një herë refuzohet, atëherë do të kalojnë shumë vite pa mundësi që të tejkalohet pengesa.

18 Shumë bashkëbisedues të autorëve të këtij raporti nga BE-ja kanë thënë se “I takon Kosovës të vendosë por të mendojë mirë edhe për pasojat”.

19 Vendimet në secilin hap të zgjerimit merren me konsensus të të gjitha vendeve anëtare të BE-së e kështu edhe për të nisur procedurën për dhënien e statusit të kandidatit.

Por në anën tjetër, nëse Kosova nuk aplikon, atëherë do të vazhdojë me vite me dilemën se a mund apo jo të bëhet vend kandidat nëse nuk është njohur nga të gjitha vendet anëtare, pa mundësi që të përparojë konkretisht dhe formalisht në proces, dhe të vazhdojë të shikojë se si vendet tjera përparojnë dhe me këtë edhe rritet hendeku mes tyre. Mundësia për të aplikuar për anëtarësim në BE do të ishte i vetmi hap i Kosovës i cili do të mund të konsiderohej si konkret dhe historik në procesin e integrimi në BE. Të gjitha formulimet tjera për “rrugën evropiane” do të ishin vetëm lojë fjalësh për të mbuluar pengesat e pakapërcyeshme që ka dhe do ti ketë Kosova në raportet me BE-në. Së paku Kosovaret do të ishin të vetëdijshëm se në çfarë pozite janë e jo të jetojnë me bindje së shpejt do të anëtarësohen në BE²⁰.

Rrethanat politike nuk janë të favorshme për Kosovën. Ato dhe do të bëhen më pak të favorshme me largimin e Britanisë së madhe nga BE-ja e cila tashmë ka humbur krejtësisht ndikimin e saj në vendimmarrje²¹. Problemi më i madh do të jetë ende qëndrimi i Spanjës. Në vend që ky shtet të zbut qëndrimin e saj Madridi po bëhet edhe më i ashpër. Krejt për shkak të situatës së brendshme e cila është përqësuar pas referendumit për pavarësinë e Katalonisë.

Pos rrethanave politike ka paqartësi edhe juridike rreth asaj se a mundet apo jo Kosova të bahet kandidat për anëtarësim e më vonë edhe të anëtarësohet në BE.

Komisioneri i BE-së për zgjerim Johanesh Hahn në fillim të mandatit të tij ishte përgjigjur negativisht në pyetjen se a mund të bëhet Kosova kandidat për BE pa qenë e njohur nga të gjitha shtetet anëtare²². Ai kishte thënë atëherë se për një gjë të tillë duhet të jetë e njohur nga të gjithë dhe kishte porositur që fokusi të jetë në zhvillimin ekonomik, krijimin e vendeve të punës dhe zbatimin e Marrëveshjes së stabilizimit asociimit.

Por ka edhe argumentime sipas të cilave Kosova mund të nisë procedurën për të marrë statusin e kandidatit edhe pa qenë e njohur nga të gjitha vendet anëtare. Në atë rast do të mjaftonte që shtetet që nuk e kanë njohur Kosovën të mos e kundërshtojnë vendimin në Këshillin e BE-së për të dhënë mandat Komisionit Evropian për të nisur procedurën²³. Diçka e ngjashme kishte ndodhur me Marrëveshjen e Stabilizimit Asociimit por për dallim nga ajo procesi i zgjerimit bëhet përmes negociatave me vendet anëtare e jo me Komisionin Evropian.

Në një studim të punuar nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike²⁴, konkludohet se janë të tejkalueshme pengesat ligjore me të cilat ballafaqohen aspiratat e Kosovës **për statusin kandidatit**.

“Neni 49, i cili prima facie duket se imponon një kusht që Kosova nuk është në gjendje të përmbushë, domethënë të jesh të kualifikuar si një ‘shtet’ - nuk do të përfshinte njohjen e shtetit nga Bashkimi Evropian, duke parë se një kompetenca e tillë nuk është përcaktuar në Traktat. Si rezultat, termi “shtet evropian” nuk nënkupton shtetësinë, njohje nga BE, e cila nuk ka kompetenca për ta bërë këtë, apo shtetet anëtare, të cilat kanë të drejtë të pa-

20 Sipas anketave Kosovaret kanë dalë të jenë qytetarët më optimistë në rajon sa i përket afateve kohore se kur do të mund të anëtarësohet vendi i tyre në Bashkimin Evropian.

21 Shumë diplomatë Evropian pranojnë se Londra ka qenë pa dyshim një prej zërave më të favorshëm për Kosovën brenda Bashkimit Evropian.

22 Koha ditore. 6 Nëntor 2015. Internistë Johanesh Hahn.

23 Kështu mendojnë edhe disa zyrtarë të qeverisë së Kosovës.

24 Statusi i kandidatit të BE-së për Kosovën - një qëllim i arritshëm. Qershor 2017.

varur për të njohur këdo që dëshirojnë” thuhet në studimin e Grupit për Studime Strategjike dhe Politika i cili konkludon se Kosova, ligjërisht mund të aplikojë për status kandidati nëpërmjet të procedurës konvencionale të paraparë në nenin 49²⁵.

Nëse nuk do të ketë ndonjë zhvillim dramatik nuk pritet që vendet anëtare që nuk e kanë njohur Kosovën ta bëjnë së shpejti një gjë të tillë, së paku jo të gjitha këto 5 shtete. Madje, me përjashtim të Parlamentit Evropian, për njohje nuk ka thirrje ndaj tyre nga asnjë adresën BE. Edhe në Shërbimin e Veprimit të jashtëm të BE-së (EEAS) vazhdojnë ta shohin jo si pengesë por si përparësi faktin se 5 shtete nuk e kanë njohur Kosovën dhe në këtë mënyrë i mundësojnë BE-së që të jetë neutrale ndaj statusit dhe të mund të jetë “lehtësuese” në dialogun mes Kosovën dhe Serbisë.

Pjesa ndoshta më e rëndësishme për Kosovën në tentativat e BE-së do të jetë insistimi që Serbia të arrijë me Kosovën një normalizim gjithëpërfshirës të raporteve. Dhe kjo, mendohet në BE, duhet të bëhet në mënyrë që “të dyja palët të vazhdojnë të papenguara rrugën e tyre përkatëse evropiane”. Por, së paku deri tash, Serbia nuk e pengon e as që mund ta pengojë formalisht avancimin e Kosovës në procesin e integrimi Evropiane. Këtë mund ta bëjnë shtetet që nuk e kanë njohur Kosovën apo shtetet tjera anëtare. BE gjithsesi dëshiron të sigurohet që kur Serbia të bëhet anëtare e BE-së ajo të mos jetë në pozitë të pengojë pastaj integrimin e Kosovës.

25 Traktati i Lisbonës

Konkluzat

Ky vit do të sjell padyshim një dinamikë më të madhe në procesin e zgjerimit të BE-së me Ballkanin Perëndimor. Zhvillimet që priten të ndodhin, e që janë përmendur në këtë punim, dëshmojnë për një dinamikë të tillë çfarë nuk është parë në vitet e fundit.

Në një mënyrë, duke miratuar një strategji në muajin shkurt vetëm për Ballkanin Perëndimor, dhe pakot vjetore për procesin e zgjerimit në Prill, Komisioni bën ndarje të qartë mes vendeve të rajonit të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë në procesin e zgjerimit. Kjo mendohet se do të ketë ndikim pozitiv në rritjen e mbështetjes për zgjerim tek shtetet e tashme anëtare dhe qytetarët e tyre të cilët kur shprehen kundër zgjerimit e bëjnë këtë kryesisht për shkak të dyshimeve që kanë për anëtarësimin e Turqisë.

Viti 2018 do të sjellë edhe një plan indikativ kohor se kur do të mund cili vend të bëjë hapa drejt anëtarësimit në BE. Mali i Zi dhe Serbia do të mund të përmbyllin negociatat deri në vitin 2023 ndërsa të bëhen anëtare në vitin 2025. Deri në atë kohë vendet tjera do të duhej të jenë të avancuara në proces. Por ky mbetet vetëm një skenar i mundshëm pozitiv i cili do të varet nga shumë kushte.

Strategjia e zgjerimit e Komisionit Evropian, që do të miratohet me 6 shkurt 2018, mund të përmend edhe afate të qarta kohore se kur do të mund të përmbyllin negociatat e kur të bëhen anëtare Mali i Zi dhe Serbia. Shqipëria dhe Maqedonia mund të marrin rekomandimin e Komisionit Evropian gjatë këtij viti për të nisur negociatat e anëtarësimit. Bosnja e Hercegovina, e cila ka aplikuar për anëtarësim, pritet të dorëzojë më në fund përgjigjet në pyetësor dhe Komisioni të nisë punën në përpilimin e opinionit për dhënien e statusit të kandidatit. Kosova nuk pritet të ketë ndonjë mundësi të ndonjë hapi konkret përpos nëse vendosë të bëjë aplikimin formal për anëtarësim në BE.

Aplikimi për anëtarësim në BE mund të jetë një test i domosdoshëm që Kosova ta bëjë por ai sjell edhe rreziqe. Aplikimi mund të mos merret fare parasysh, të mbyllet diku në sirtar, apo edhe të refuzohet për shkak të mosnjohjes nga 5 vendet anëtare. Por nëse Kosova nuk aplikon, atëherë do të vazhdojë me vite me dilemën se a mund apo jo të bëhet vend kandidat nëse nuk është njohur nga të gjitha vendet anëtare, pa mundësi që të përparojë konkretisht dhe formalisht në proces, dhe të vazhdojë të shikojë se si vendet tjera përparojnë dhe me këtë edhe rritet hendeku mes tyre.

Viti 2018 do të jetë sfidë edhe për dialogun për normalizimin e raporteve mes Kosovës dhe Serbisë. BE dhe dy Kryetarët e dy shteteve, ai i Kosovës Hashim Thaçi dhe i Serbisë Aleksandar Vuçiq, kanë aspirata të mëdha për arritjen e një marrëveshje historike por situata e paqartë në Kosovë e bën një marrëveshje të tillë jo të lehtë.

Në BE është përmirësuar dukshëm situata ekonomike, të gjitha vendet anëtare kanë rritje ekonomike, asnjëra nuk është më në recesion, në të gjitha po ulet papunësia dhe kriza financiare është tejkaluar. Kjo po ashtu ka ndikuar që BE të mund të mendojë për kthimin e besimit në procesin e zgjerimit. Por zhvillimet politike të brendshme në disa shtete anëtare, sidomos rritja e mbështetjes për ekstremin e djathtë, do të jetë sfidë për politikën e BE-së, përfshirë edhe ndaj procesit të zgjerimit.

